

**STATUT E AKTHEMELIMI
SHOQERISE TREGTARE
"NABADAR" Sh.p.k**

KREU I

**EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA
NENI 1**

Ne Tirane, sot me daten 16/02/2022 (dy mije e njezet),shtetasit:

- Luigi di Naro, lindur dhe banues ne Agrigento, Itali rruga Randazzo 64, 95125 Catania Itali, me 29.01.1975, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me nr.pashaporte YB6478415.

Me vullnet të lire të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak vendosi te hartoje kete Statut e Aktthemelimi mbeshetur ne nenet e meposhtme e si dhe ne dispozitat ligjore si; Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ligjin me nr 9901 date 14.04.2008 "PËR TREGTARET E SHOQERITE TREGTARE"

NENI 2

Shoqeria tregtare eshte vendase dhe emertohet "Nabadar" Sh.p.k emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.


NENI 3


Selia e shoqerise "Nabadar" Sh.p.k eshte ne Tirane, ne Rruga Abdyl Frasheri, Pallati Hekla, Shk.1, Ap.45, K.9

NENI 4

Shoqeria "Nabadar" Sh.p.k do te kete si objekt te veprimtarise te saj;

- Projektimi, prodhimi, ndërtimi, mirëmbajtje, menaxhimin, blerjen dhe shitjen e sistemeve kompjuterike, duke përfshirë pajisjet hardware, te aplikuar në fushën e proceseve industriale, administrative. Zhvillimi, organizimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit dhe strategjitë e biznesit. Konsulenca për kompani ose grupe industriale, bankare, sigurimi dhe financiare në përgjithësi,per institucionet publike dhe private.
- Perpunimi i të dhënave, të kontabilitetit, menaxhimit të pasurive te korporatave, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e dokumenteve dhe bazave të të dhënave me te tretet, si dhe shërbime të tjera konsulence ne fushen e programeve financiare, pajisje elektronike dhe pajisjet e telekomunikacionit.





- Shoqeria mund të kete pjesëmarrje në shoqeri të tjera që kanë qëllime të ngjashme dhe plotësuese, për të gjitha transaksionet financiare, bankare dhe komerciale, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të nevojshme për të ndjekur qëllimet e veta.

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte kapital ne Leke ne vleren 100,00 leke (njqined) formuar dhe nenshkruar nga ortakët ne 1 kuote si me poshte;

- Luigi di Naro zoterues i 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 100% me vleren 100,00 Leke (njqined);

I depozituar sipas ligjit.

Ortakët kane pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjetër të fituar ne rrugë të ligjshme.

Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte I papercaktuar duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit ne QKR, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

KREU II KUSHTET EKONOMIKE


NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qellim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj. Ortakët dhe administratori i saj, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria .

NENI 9

Pjesët e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortakët kane të drejta të transferojne jashte territorit të Republikës se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre e perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tille vendimet e asamblese se ortakeve te shoqerise duhet të merren paraprakisht me shkrim.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo t'u behen të ditura.



NENI 10

Me vendim të ortakeve të shoqërisë, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarrvajtjen e shoqërisë.

NENI 11

Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose disa ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

KREU III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKES TË VETME

NENI 12

Asambleja e Ortakeve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji në fuqi. Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat një ose me shumë administratoreve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokures.

NENI 13

Administratori i shoqërisë është Luigi Di Naro, me pashaportë nr. YB6478415 me afat 5- vjeçar. Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të Asamblesë së ortakëve, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Njesitë e tjera strukturore të shoqërisë si Dege apo perfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë e tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 14

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit në QKR, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të kësaj qendre. Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe paisur me certifikatat përkatëse në Organin e Tatimit Taksave të Tiranës.

NENI 15

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

Luigi Di Naro
LR

Luigi Di Naro

NENI 16

Asambleja e Ortakeve e shoqerise ka dhe keto të drejta dhe detyra kryesore :

- Të marre pjese ne drejtimin dhe administrimin e gjithanshem të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise dhe të cdo veprimtarie tjeter të saj, kur ajo ushtrohet ne perputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.
- Të kerkoje dhe t'i jepen të gjitha informatat qe kane të bejne me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarise se shoqerise, si dhe i të gjitha dokumentave të perpunuara nga shoqeria, ato qe
- kane të bjene me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të bilancit kontabel apo per cdo llogari të celur si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese. Të marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne cfaredo forme apo sasi, sipas kontributit të dhene prej tij.
- Të kryeje sherbime per realizimin e objektiveve dhe qellimeve të veprimtarise se rregullt ligjore të Shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon ne cdo kohe Administratorin e shoqerise, cakton ekspertin kontabel të autorizuar. Ekspertin kontabel të autorizuar e ngarkon per pregatitjen dhe nxjerrjen e bilancit vjetor ekonomiko financiar të aktivitetit të shoqerise, të cilin ia paraqesin ortakeve mbi bazen e raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit të tij, ortaket kane të drejten e miratimit vendimor të ketij bilanci.

Nxjerrja e bilancit financiar vjetor mbi bazen e të dhenave të kontabilitetit, behet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar. Asambleja e Ortakeve kryesisht si dhe Administratori , ushtrojne dhe keto të drejta :


Mundesohen per të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike qe konsiderohen se jane të domosdoshme per ushtrimin e gjithanshem dhe fitimprures të veprimtarise tregtare të shoqerise sipas qellimeve dhe objektiveve të saj sic mund të jene:

- Të lidhin kontrata të ndryshme qe kane per objekt blerjen, shitjen, kembimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizik dhe ata juridike, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe ne rast të blerjes se pasurive të paluajtshme, të bejne dhe transkriptimin e pronesise se saj ne favorin e tyre ne Hipoteken e ZRPP, per të dokumentuar nje rrethane të tille dhe si shtese të kapitalit ne natyre.
- Të kryeje cdo lloj veprimi prane të gjitha zyrave private dhe shtetore, Bankat e cdo niveli etj. qe kane të bejne me Garancite, sipermarrjet, marrjen e kredive, siguracioneve, transportit brenda dhe jashte shtetit), per zhdoganimin e mallrave të importuara apo eksportuara, ate të plotesimit me korektese të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes ne kohe të cdo detyrimi. Ne rastet kur keto veprime juridike kryhen nga administratori i emeruar nga ortaku i vetem ose personi qe e perfaqeson ate mbi bazen e prokures, keta ne perfundim të realizimit të veprimit perkates detyrohen qe të njoftojne menjehere dhe t'i japin llogari ortakut te vetem.

Administratori ose perfaqesuesi me prokure jane individualisht pergjegjes ndaj shoqerise apo të treteve, per veprime të kryera ne shkelje të ligjeve dhe qe bien ne kundertshtim me kete Statut dhe per demin e shkaktuar me faj, sipas rastit, Ortaku mund të ngreje dhe të kerkoje ndaj tyre padi per shlyerjen e demit civil, duke perfshire dhe të drejten per të bere kallezim per ndjekje penale ne Prokurorine e juridiksionit tokesor ku ka seline shoqeria

NENI 17

Perfaqesimi i shoqerise ne mardheniet me të tretet si brenda dhe jashte shtetit si rregull dhe pergjithshem i perket Administratorit te shoqerise.



NENI 18

Asambleja e Ortakeve, kane të drejte qe per nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqerise, të marrin ne pune shtetas të ndryshem, madhor dhe me zotesi të plote per të vepruar, duke lidhur kontrate sipas kritereve qe parashikohen ne Kodin e Ri te Punes ne fuqi dhe me ligjin nr. 7703 date 11.05.1993 " Per sigurimet shoqerore " te ndryshuar si dhe ne pershtatje me rregullat e brendshme të disipline teknike dhe të punes të caktuara nga vete punedhenesi.

KREU IV BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 19

Veprimet ekonomiko financiare të shoqerise, mbyllen me daten 31 Dhjetor të cdo viti. Per nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqerise, mbi bazen e aktivitet dhe pasivit ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve nje ekspert kontabel i autorizuar.

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakes të vetme.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakes se vetme per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe kane.

NENI 20

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per tu zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtare.

NENI 21

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortakut, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

NENI 22

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

Blendo Kono
[Signature]

[Signature]

NENI 23

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte krijuar sic mund të jene :

- Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj;
- Mungesa e përkohshme e burimeve ekonomike dhe financiare për qëllime të biznesit;
- Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare";
- Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

NENI 24

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrimit Tregtar.

NENI 25

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj

NENI 26

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten ceshtjen mund të behet objekt konflikti gjyqsor ne Gjykates e Rrethit Gjyqsor Tirane.

NENI 27

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet udhezimeve plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga Asambleja e Ortakeve si dhe legjislacioni ne fuqi.

NENI 28

Ky statut u redaktua ne 2 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e saj orgjinale.

THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE
LUIGI DI NARO

